

# STATUTI I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## “OXHAKU ” SHPK

### KREU I

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### NENI 1

Ne Tirane sot ne date 05/04/2018 ,në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë, ortaket:

- 1. ALTIN TROQE**, I biri I Lame, lindur në Tragjas, më 16/11/1972 dhe banues ne Tirane ,RR” Sami Frasheri, pallati Vega shpk shk 1,ap 11 , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me leternjoftimin Nr.033491455 dhe Nr. Personal H20916052G
- 2. ASTRIT KOÇI**, i biri I Fatbardhit , lindur në Berat më 05/03/1973, dhe banues në Tirane, në adresën Rruga”Sokrat Mehilli”godina 1 , shk5, Ap 14,Yzberisht ,madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.027547328 dhe nr personal H30305078T
- 3. LEONARD PAPAS** , I biri Kristo, lindur në Kucove, më 01/07/1973,dhe banues Tirane ,ne Blv BAjram Curri ,kompleksi Amfora,shk 1 ap 30 ,madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me leternjoftimin Nr.032688796 dhe Nr. Personal H30701078L

si themelues te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar, vendosen të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtëme:

### KREU II

#### EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

## NENI 2

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar **“OXHAKU”** sh.p.k. me themelues **z.Altin Troqe, z.Astrit Koci, z.Leonard Papas**

## NENI 3

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nëshkruara për kapitalin.

## NENI 4

Shoqëria e ka selinë e saj në rrugën "Myrteza Kellici", pasuria me nr 6/38 ,zona kadastrale 8150,Tirane. Me miratim te organeve të saj kompetente ajo mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH apo jashtë saj.

## NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

## KREU III

### O B J E K T I

## NENI 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

**-Restorant dhe Bar-Kafe**

## KAPITALI

## NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) Leke, i zotëruar nga keta ortak:

Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron	Shuma kapitalit
ALTIN TROQE	33%	1 kuotë	33 lek
ASTRIT KOCI	33%	1 kuotë	33 lek
LEONARD PAPAS	33%	1 kuotë	33 lek

## NENI 8

### KUOTAT E KAPITALIT

Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

## **NENI 9 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakevë brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që do j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKR.

Kuotat janë të papjestueshme.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

## **KREU IV**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

#### **NENI 10**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**



## NENI 11 KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të

këtij neni;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

## NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESË

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare". Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortatakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit.

## NENI 13 THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të

regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

## ORGANI ADMINISTRATIV

### NENI 14

1. Administrator i shoqërisë është z. **ASTRIT KOCI**, i biri I Fatbardhit , lindur në Berat më 05/03/1973, dhe banues në Tirane, në adresën Rruga "Sokrat Mehilli" godina 1 , shk5, Ap 14, Yzberisht ,madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.027547328 dhe nr personal H30305078T

### NENI 15

#### KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është **5 vjet**, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.



## KREU V

### PRISHJA E SHOQËRISË

#### NENI 16

Shoqëria “**OXHAKU**” sh.p.k prishet:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKR;
- ç) me vendim të gjykatës;

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likuidimit emrit te shoqerise i shtohet pjesa “Ne likujdim” qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqeria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Pergjitheshme, kerkon çregjistrimn e shoqerise prane QKR, pas shperndarjes se aktiveve te mbetura te shoqerise.

### VITI FINANCIAR

#### NENI 17

Ne perputhje me ligjin shoqeria do te kete nje regjister ne te cilen mbahen balance vjetore, raporte financiare vjetore dhe cdo kerkese tjeter ligjore.

#### NENI 18

Viti financiar i shoqerise fillon ne 1 janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 dhjetor te po ketij viti me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon ne 31 dhjetor.

### DIVIDENTËT

#### NENI 19

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si dividente, bazuar ne kuotat qe zoteron çdo ortak.

### PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

#### NENI 20

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti, dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqeria do te kete vulen e vete ne te cilen shkruhet emri i shoqerise sic e prashikon ligji.


- 21.1 Per ato qe nuk jane parashikuar ne kete statut zbatohen dispozitat e e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Statuti eshte hartuar ne 5 (pesë) kopje origjinale me te njejten fuqi ligjore.




**ORTAKET THEMELUES**

**ALTIN TROQE**

Altin Troqe  


**ASTRIT KOCI**

ASTRIT KOCI  


**LEONARD PAPAS**

Leonard Papas  
